

Durrësi, 37 përqind e shkëmbimeve tregtare me anije me portet e Italisë.

30 Janar 2012



Portet e Italisë janë partnerët kryesorë në shkëmbimet tregtare shqiptare përmes portit detar të Durrësit, duke shënuar gjatë vitit të kaluar një rritje prej 330 mijë ton krahasuar me vitin 2010. Nga 2.7 milion ton mallra të përpunuara vetëm me anije tregtare gjatë vitit 2011, rreth 37 përqind i përkasin import-eksporteve me vendin fqinj, ndërsa në listën e vendeve me shkëmbime vjetore mbi 100 mijë ton janë Turqia, Malta, Rusia, Ukraina, Kina, Franca dhe Kroacia.

Sipas statistikave të Autoritetit Portual, gjatë vitit 2011 mbi 1 milion ton mallra të ndryshme janë shkëmbyer mes Durrësit dhe 20 porteve të ndryshme të gadishullit italian. Drejt vendit fqinj janë nisur me anije mbi 493 mijë ton mallra të prodhuara në vendin tonë, ndërsa rreth 508 mijë ton mallra importi kanë mbërritur në Durrës tonë në rrugë detare.

Vendin e parë në shkëmbimet me anije e mban porti i Gioia Tauros (Itali), ku kanë mbërritur 275 mijë ton mallra shqiptare me kontejnerë, ndërsa në Durrës kanë mbërritur nga I njejtë port italian rreth 402 mijë ton mallra të tjerë importi. Porti tranzit i kontejnerëve në Gioia Tauro mbetet pika me vëllimin më të madh të transportit nga Durrësi drejt porteve të tjera në 35 vende të botës.

Portet e Turqisë, Maltës dhe Ruisë kanë kryer me Durrësin një volum transporti nga 232 mijë-320 mijë ton, ndërsa vëllime vjetore transportesh nga 100.000-200.000 ton kanë gjithashtu Ukraina, Kina, Spanja, dhe Kroacia.

Drejt porteve të Kinës gjatë vitit 2011 janë nisur 120 mijë ton mallra shqiptare, ndërsa nga portet e Greqisë gjatë vitit të kaluar kanë mbërritur 79 mijë ton mallra gjithsej.

